

Vendim nr. 181 datë 26.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 26.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (H) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **ADRIANA BUSHATI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 4095, datë 24.11.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-156, datë 26.01.20213 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 134, pika 2 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/a dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja rezulton se ka qenë e punësuar pranë ish-Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP). Me urdhrin nr. 498 prot., datë 03.10.2013 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, kërkuesja është liruar nga detyra e Inspektore në Sektorin e Vlerësimit dhe Shpërndarjes së Kompensimit në Drejtorinë e Kompensimit të Pronave dhe është emëruar në detyrën e Inspektore në Sektorin Juridik dhe të Kontrollit në Drejtorinë e Kthimit të Pronave.

2. Me shkresën nr. 255 prot., datë 07.10.2013, kërkuesja rezulton të ketë shprehur kundërshtitë e saj lidhur me lëvizjen në detyrë, duke kërkuar rikthim në detyrën e mëparshme. Drejtori i Drejtorisë së Kthimit të Pronave, nëpërmjet shkresës nr. 498/1 prot., datë 14.10.2013, i ka propozuar drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës me kërkuesen, me motivacionin e refuzimit, pa shkaqe të arsyeshme, për t'u paraqitur e për të marrë detyrën e caktuar.

3. Me shkresën nr. 255/1 prot., datë 21.10.2013 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, kërkueses i është bërë me dije takimi i datës 23.10.2013, i planifikuar nga punëdhënësi për diskutim mbi vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu, rezulton se me urdhrin nr. 509 prot., datë 23.10.2013 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, kërkueses i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me efekte të menjëhershme financiare. Në këto kushte, kërkuesja ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe ka kërkuar pranimin e saj, sipas objektit.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4621, datë 09.09.2014, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë dhe detyrimin e të paditurit t'i paguajë kërkueses 12 muaj pagë. Për kërkimet e tjera të padisë ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim AKKP-ja.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4095, datë 24.11.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 4621, datë 09.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke rrëzuar kërkesëpadinë. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesja.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-156, datë 26.01.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar.

7. Në datën 23.05.2023, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

Vendim i Kolegjit

Kërkuese: Adriana Bushati

II

Pretendimet e kërkueses

8. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

- 8.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit edhe pse në prani të shkaqeve që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe, për më tepër, në kushtet e qëndrimeve të kundërta të gjykatave më të ulëta. Nëse do të pranim se ndryshimi i pozicionit të punës nuk do të përbënte një zgjidhje të njëanshme të kontratës së punës nga pala e paditur, përsëri gjykata e apelit duhet të kishte hetuar në mënyrë më të plotë shkaqet që justifikonin zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Në kohën e zgjidhjes së kontratës së punës kërkuësja ka qenë duke përfituar pagesë paaftësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi. Gjykata e apelit ka identifikuar dispozita të ndryshme për zgjidhjen e çështjes dhe u ka dhënë atyre interpretim të ndryshëm, duke mos u dhënë në këtë mënyrë përgjigje përfundimtare pretendimeve të kërkueses.
- 8.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të barazisë së armëve*, pasi vlerësimi i bërë nga Gjykata Administrative e Apelit është i njëanshëm dhe subjektiv. Vendimi i gjykatës së apelit nuk i plotëson kërkesat për të qenë një vendim i arsytuar. Gjithashtu, gjykata e apelit ka vendosur në kundërshtim me provat dhe faktet, pasi nuk ka hetuar në mënyrë të plotë për shkaqet që justifikonin zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës, duke e kaluar barrën e provës në mënyrë të njëanshme te punëmarrësi dhe duke e vendosur kërkuesen në pozita të disfavorshme. Të gjitha këto pretendime janë ngritur edhe në rekurs, por Gjykata e Lartë nuk ka riparuar shkeljet e gjykatave më të ulëta dhe as nuk u ka dhënë përgjigje të arsytuar shkaqeve të rekursit në situatën që dy gjykatat e tjera i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes së kërkueses.
- 8.3. *Së drejtës së ankimit*, pasi në prani të dy vendimeve diametralisht të kundërta të dy gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë duhej ta shqyrtonte në themel çështjen dhe t'u jepte përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs. Për këtë shkak, Gjykata e Lartë ka cenuar edhe të drejtën e aksesit substancial.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000 që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në verifikim të plotësimi të këtyre kriterëve, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në gjykimin në të cilin janë dhënë vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi në Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kolegji vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit të zakonshëm, ku vendimi i fundit që ajo kundërshton është ai i Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, kërkuësja i ka shteruar mjetet juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

12. Kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit që ka përmbyllur procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj saj, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është i datës 26.01.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 23.05.2023, nëpërmjet shërbimit postar, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, sipas jurisprudencës kushtetuese, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit që vënë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, referuar të gjitha argumenteve të sjella nga kërkuësja për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës së aksesit, së drejtës së ankimit, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të barazisë së armëve, Kolegji vëren se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të fakteve dhe provave, si dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe, si të tilla, duke qenë me natyrë ligjore, nuk mund të bëhen pjesë e juridiksionit kushtetues. Në lidhje me pretendimin e kërkuësës se në kushtet e dy qëndrimeve diametralisht të kundërta të gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte në themel çështjen dhe t’u jepte përgjigje pretendimeve të saj, Kolegji thekson se ajo që merr rëndësi përcaktuese në këto raste është natyra kushtetuese e pretendimeve që kërkuësja ka ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Vetëm kur pretendimet në rekurs synojnë verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit*, duhet ta ushtrojë funksionin e saj për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në seancë gjyqësore dhe t’u japë përgjigje të arsytuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs (*shih vendimin nr. 7, datë 20.01.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese*).

Vendim i Kolegjit

Kërkuëse: Adriana Bushati

15. Kolegji vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura nga kërkuesja në rekurs dhe pasi i ka verifikuar ato, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se Gjykata Administrative e Apelit ka sqaruar plotësisht rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve të lidhura me të dhe se konkluzioni i asaj gjykate është rrjedhojë e një analize tërësore dhe objektive të provave. Sipas tij, të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga gjykata e apelit, duke i bërë një analizë të hollësishme dispozitave të Kodit të Punës, të cilat rregullojnë mosmarrëveshjen konkrete dhe se këto qëndrime janë bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Kurse për atë pjesë të pretendimeve të rekursit që ngre çështje të vlerësimit të provave, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë dhe se nëpërmjet këtij gjykimi nuk mund të pretendohet të rihapet edhe një herë shqyrtimi gjyqësor i provave (*shih paragrafët 20 dhe 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

16. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj si gjykatë e ligjit, ndërkohë që vetëm fakti se ajo ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të vënë në dyshim vendimmarrjen e saj. Për rrjedhojë, në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, këto pretendime të kërkueses nuk janë ngritur në nivel kushtetues, duke mos arritur ajo të provojë cenimin e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, nga vendimmarrja e kundërshtuar e gjykatave të zakonshme.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Vendim i Kolegjit

Kërkuese: Adriana Bushati

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Vendim i Kolegjit

Kërkuese: Adriana Bushati